

Adriatik Hoxha, sërish rekord kombëtar në Hungari



Atleti i Kombëtares shqiptare, Adriatik Hoxha, vendos një tjetër rekord kombëtar. Pas atij të vendosur më 12 qershor 18.46 metra, në një Miting ndërkombëtar të zhvilluar në qytetin e Zombatelit në Hungari ku edhe është grumbulluar prej kohësh, dje shqiptari i gjyles ka përmirësuar rezultatin e tij me 18.90 metra. “Më datën 19 qershor, në Mitingun e Hungarisë me pjesëmarrjen e atletëve vendës, por edhe atyre nga Sllovenia dhe Kroacia ku edhe unë mora pjesë, arrita të thyej sërish rekordin

kombëtar me rezultatin 18.90 metra. Për këtë arritje shpreh falënderimet e mia për Federatën Shqiptare të Atletikës dhe presidentin e saj z.Gjergji Rulin dhe sekretarin e përgjithshëm Nikolin Dionisi, për mundësinë e artë që më kanë dhënë. Në më pak se një muaj qëndrimi në Hungari unë kam arritur të thyej 2 herë rekordin kombëtar”, deklaroi atleti i Kombëtares shqiptare. Pretendimet Pavarësisht këtij rezultati, Hoxha është i sigurt se mund të shkojë edhe më larg se kaq. “Realisht, gjatë kësaj kohe po bëj një fazë përgatitore intensive. Jam i sigurt dhe për këtë jap fjalën se do të vendos një tjetër rekord kombëtar. Do të më shihni pak më vonë, ndoshta në garën tjetër të muajit korrik që do të zhvillohet në Budapest, pretendoj 19.50 metra. Ky rezultat i arritur ka qenë në pritshmëritë e mia, por që nga vetja kërkoj edhe më shumë. Me kushtet ku po stërvitem, përfshirë këtu trajnerin, ushqimin, regjimin dhe kohën që do të kem në dispozicion për 2 muaj më bëjnë të besoj te një rezultat që do të surprizojë, pse jo në kufirin e 1 metrit. Kam fatin e mirë që të stërvitem me elitën e atletikës botërore, kampionë olimpikë, kampionë bote dhe rekordmenen për të reja për femra në çekiç. Kjo më ka dhënë një shtysë të madhe për të dhënë maksimumin tim”, deklaroi për gazetën “Panorama Sport” rekordmeni Adriatik Hoxha.

OLGERT SERANI

Burimi: <http://www.panorama-sport.com/zoom/adriatik-hoxha-serish-rekord-kombetar-ne-hungari/#ixzz3UTrJ0mYZ>